KOMUNIKATË PËR WEB

Mbahet takim për zgjatjen e Regjistrimit të Popullsisë (ReKos 2024)

18 maj 2024

Në ambientet e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) sot u mbajt takim i jashtëzakonshëm për zgjatjen e afatit të Regjistrimin e Popullsisë (ReKos 2024) deri më 24 maj.

U.d i Kryeshefit Ekzekutiv i ASK-së, Avni Kastrati, njoftoi stafin e ASK-së me planin e veprimit për gjithë territorin e Kosovës. Ai tha se regjistrimi gjatë kësaj jave do të realizohet me stafin e ASK-së, me grupe mobile, të cilët do të dalin në terren për t'i kryer intervistat me qytetarë.

Në planin e verpimit janë paraparë tri grupe, kur Grupi i parë do të punojnë në dy ndërrime në qendrën e thirrjeve, të cilët pastaj i njoftojnë dy grupet e tjera se ku duhet të shkojnë për t'i realizuar intervistat me qytetarë.

Agjencia e Statistikave të Kosovës ka kapacitete të mjaftueshme teknike dhe logjistike për të vepruar.